



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr 20029 prot.

Shkodër, me 7.10.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendimi

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin **“PËR DISA NDRYSHIME DHË SHITESA NË VKB NR 1, DATË 22.01.2016 “PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR.**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Bener BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____, datë ____ . ____ .2025

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB NR 1, DATË 22.01.2016 “PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ____/____ 2025, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.3, nenit 35 pika 1, nenit 54 germa f, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; nenit 14 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” i ndryshuar; ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar si dhe relacionit të administratës së bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në VKB-në nr 1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore në bashkinë Shkodër” të ndryshuar, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Efektet financiare të ndryshimit në paketën fiskale fillojnë në datën **01.11.2025**.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

KRYETAR

Behet BECI



Zv/Kryetar



Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

ELVIN BRAHIMI

Drejtoria Juridike

B. Legarda

Drejtoria e Arsimit

Senada Kolaj

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
Vendore

Ardit Beku

Drejtoria e Përgjithshme Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse

Guelda Dume

Policia Bashkiake

SAIMIR RRPSTENI

A stylized signature in blue ink, likely belonging to Saimir Rrpstemi.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Nr. _____ prot.

Shkodër, më _____. _____. 2025

RELACION

**“PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR 1, DATË 22.01.2016 “PËR TAKSAT E TARIFAT
VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR**

Bashkia Shkodër ka në zbatim VKB nr. 1, datë 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.

Përgjatë vitit 2025 Bashkia Shkodër ka vlerësuar, sipas fushës së kompetencave, nevojën për ndryshime dhe shtesa në paketën fiskale të cilat reflektojnë iniciativa të ndërmarra, indeksimin e çmimeve, ndryshimet ligjore apo udhëzimet përkatëse si dhe nevojën për përmirësim të shërbimeve. Ky proces ka për qëllim të sigurojë që taksat dhe tarifat vendore të pasqyrojnë më mirë kostot dhe nevojat e qytetarëve dhe bizneseve të Shkodrës.

Tarifa për Kopshte dhe Çerdhe

Sipas VKB nr. 1, datë 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar, kapitulli III.4.8 tarifa për ushqimin në kopshte është 160/ lekë, ndërsa tarifa për ushqimin në çerdhe është 125 / lekë.

Bazuar në Urdhërin e Minsitrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 76/1 datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të Çerdheve dhe Kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç” përcaktohet menuja ditore sipas grupmoshave përkatëse. Mbi bazën e këtij urdhëri dhe bazuar në çmimet përkatëse sipas INSTAT tarifa për ushqimin në kopshte (kuotë/ ditore/ lekë/ fëmijë) është 160 lekë, për ushqimin në çerdhe (kuotë/ ditore/ lekë/ fëmijë) është 125 lekë.

Si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të verifikuara kjo dhe sipas të dhënave të INSTAT, është e domosdoshme reflektimi i këtij indeksi inflacioni në kuota ushqimore ditore e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte.

Bazuar sa më sipër kërkohet që në paketën fiskale të pasqyrohet ky ndryshim, ku tarifa për ushqim në kopshte (kuotë/ ditore/ lekë/ fëmijë) të bëhet 185/ lekë dhe tarifa në çerdhe (kuotë/ ditore/ lekë/ fëmijë) të bëhet 155/ lekë.

Për rrjedhojë ndryshimet janë si më poshtë:

I. NDRYSHIMET NË KAPITULLIN III “TARIFAT VENDORE”

I.1 Tarifa shërbimi nga institucionet e kopshteve dhe çerdheve

Ishte:

III.4.8.1

Nr	Emërtimi	Njësi	Vlerë
1	Tarifë për ushqim në kopshte	Kuota ditore Lekë/ Fëmijë	160
2	Tarifë për ushqim në Çerdhe	Kuota ditore Lekë/ Fëmijë	125

Bëhet:

III.4.8.1

Nr	Emërtimi	Njësi	Vlerë
1	Tarifë për ushqim në kopshte	Kuota ditore Lekë/ Fëmijë	185
2	Tarifë për ushqim në Çerdhe	Kuota ditore Lekë/ Fëmijë	155

Masat Administrative për Agjencive Funerale/Shtëpi funerale (salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 9220, datë 15.4.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, i ndryshuar; ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 711, datë 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”; neni 36/2, ndër të tjera përcakton që:

1.Kushtet për ushtrimin e aktivitetit të agjencive të shërbimit funeral kryhen në përputhje me ligjin nr. 9220/2004, të ndryshuar.

2.Agjencitë e shërbimit funeral licencohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në drejtim të:

a) kapacitetit teknik dhe burimeve njerëzore, si garanci e vazhdimësisë dhe përshtatshmërisë të shërbimit;

b) garancisë së sipërmarrjes;

c) respektimit të rregullave të sigurisë dhe të shëndetit të punëmarrësve;

d) respektimit të legjislacionit në lidhje me realizimin e shërbimeve.

3. Agjencitë janë të detyruara të komunikojnë çdo ndryshim mbi aktivitetin e licencuar.

4.Njësitë e vetëqeverisjes vendore parashikojnë kriteret dhe kushtet plotësuese që agjencitë e shërbimit funeral duhet të plotësojnë për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit funeral dhe/ose ofrimin e shërbimit për shtëpi funerale, në lidhje me kapacitetet teknike dhe burimet njerëzore.

Sa sipër ,rezulton që licencimi i ketyre subjekteve për efekt të ligjit është në kompetencë të Njësisë së vetëqeverisjes vendore Bashkia Shkodër.

Për këtë qëllim nepërmjet VKB nr.15, datë 03.03.2025 kemi miratuar kriteret dhe procedurat për liçencimin e Agjencie Funerale/Shtëpi funerale(salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër; Në referim të ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “ Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kemi miratuar formatin e liçencës me vendim të Kryetarit të Bashkisë .

Në mbështetje të kreut VII, pika 2 të VKB nr.15, datë 03.03.2025, sa i takon sanksioneve administrative në lidhje me kundërvajtjet administrative/shkeljet që mund të konstatohen ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë: Agjenci funerale/shtëpi funerale (salle pritje), propozojmë si vijon:

SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MËNYRA E CAKTIMIT TË TYRE

I. Sanksionet/Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara.

1.Sanksionet/Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim janë :

- a. Paralajmërim me shkrim/Akt konstatimi.
- b. Procesverbal për kundërvajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobës.
- c. Pezullimin e liçencës dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit sipas afatit të pezullimit.
- d. Heqjen e liçencës dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit.

2.Sanksioni “Paralajmërim me shkrim” është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e detyrës për kundërvajtësit.

3.Në rast përsëritje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtje administrative tjetër sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.

4. Në rast vijimi të kryerjes së kundërvajtjes/kundërvajtjeve duke mosrespektuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi pas aplikimit të masës administrative me gjobë, ndaj subjektit vijojnë masat në rend hierarkik :

- a. Pezullimin e liçencës dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit sipas afatit të pezullimit.
- b. Heqjen e liçencës dhe mbylljen e ushtrimit të aktivitetit.

II. Masa e sanksioneve (gjobës) për kundërvajtjet administrative .

Masat e sanksionit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në këtë vendim:

1. Për kundërvajtjet në lidhje me mos plotësimin dhe mos respektimin e secilit nga kushtet apo kriteret e përcaktuara në VKB nr.15, datë 03.03.2025 kemi miratuar kriteret dhe procedurat për liçencimin e Agjencie Funerale/Shtëpi funerale(salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër”, struktura përgjegjëse janë Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Masa e gjobës përcaktohet në vlerën **20.000** (dy mijë) lekë.

2. Për kundërvajtjet në lidhje me shkeljen e rregullave të përdorimit të hapësirës publike nga subjekte që ushtrojnë veprimtarinë: Agjenci funerale/shtëpi funerale (salle pritje), struktura përgjegjëse janë Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Masa e gjobës përcaktohet në vlerën **20.000** (dy mijë) lekë.

III. Kompetenca për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative

1. Strukturat përgjegjëse janë Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave Vendore.

2. Kundërvajtjet administrative, sipas këtij vendimi, konstatohen dhe shqyrtohen gjatë veprimtarisë rutinë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ose sipas sinjalizimeve apo ankimeve të individëve dhe qytetarëve të ndryshëm.

3. Gjatë procedurës për konstatimin dhe shqyrtimin e një kundërvajtje administrative, struktura konstatuese përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, nëse e sheh të nevojshme, ka të drejtë të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit të dyshuar për kryerjen e kundërvajtjes, apo shkeljes së konstatuar.

IV. Ekzekutimi /Zbatimi Vullnetar

1. Gjohat paguhen vullnetarisht brenda 10 ditëve, pas kalimit të afatit të parashikuar, zbatohet një kamatvonesë prej 2%(dy përqind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonese.

Shuma totale e kamatvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.

2. Pagesa vullnetare e gjobës dhe/ose kamatvonesa bëhet me marrjen e fletë gjobës, dhe pagesën e vlerës së detyrimit pranë bankave të nivelit të dytë, apo pranë Filialit Posta Shqiptare, Sh.A Shkodër.

V. Ekzekutimi i dënimit për kundërvajtjet administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv.

1. Vendimi për kundërvajtjet administrative, që parashikon dënimin me gjobë apo shpërblimin e dëmit, i vendosur nga strukturat përgjegjëse në zbatim të këtij vendimi përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i tyre kryhet sipas legjislacionit në fuqi.

2. Në rast se nga aktet ligjore nënligjore nuk parashikohet ndryshe, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është struktura përgjegjëse për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre.

3. Të ardhurat nga gjobat dhe për kundërvajtjet dhe shpërblimin e dënimeve të parashikuara nga ky vendim, kalojnë tërësisht në buxhetin e Bashkisë së Shkodrës.

Tabele Gjoha

Tabelë nr. _____, Gjohat e parashikuara për shkeljet e konstatuara ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë: Agjenci funerale/ shtëpi funerale (salle pritje).

Nr.	Emërtimi	Njësia	Gjoha
1.	Ushtrimi i veprimtarisë Agjenci funerale/ shtëpi funerale (salle pritje), në mos plotësim dhe mos respektim të secilit nga kushtet apo kriteret e përcaktuara në VKB nr.15, datë 03.03.2025.	Lekë	20.000

2.	Shkelja e rregullave të përdorimit të hapësirës publike nga subjekte që ushtrojnë veprimtarinë: Agjenci funerale/shtëpi funerale (salle pritje).	Lekë	20.000
----	--	------	--------

1. Strukturat përgjegjëse janë Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
2. Gjobat paguhen vullnetarisht brenda 10 ditëve.
3. Pas kalimit të afatit 10 ditor të parashikuar për ekzekutimin vullnetar, zbatohet një kamatvonesë prej 2%(dy përqind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonese.
4. Shuma totale e kamatvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.
5. Pagesa vullnetare e gjobës dhe/ose kamatvonesa bëhet me marrjen e fletë gjobës dhe pagesën e vlerës së detyrimit pranë bankave të nivelit të dytë, apo pranë Filialit Posta Shqiptare, Sh.a Shkodër.
6. Në rast se nga aktet ligjore nënligjore nuk parashikohet ndryshe, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është struktura përgjegjëse për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre.

KRYETAR



Zv/Kryetar

[Signature]
Drejtoria e Arsimit
[Signature]

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
Vendore

[Signature]
Policia Bashkiake
[Signature]